



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

Datë/Datum

900/20

24.11.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PRISHTINË - PRIŠTINA PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.900/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i operatorëve ekonomik "Parajsa & Emsa"- Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Eing Com"shpk & N.P.T "Daqa"-Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rrëth shtratit të lumbit Sitnica", me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Lipjan, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik "Parajsa & Emsa"- Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rrëth shtratit të lumbit Sitnica", me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Lipjan.

**II. VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rrëth shtratit të lumbit Sitnica", me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Lipjan.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Parajsa & Emsa”- Lipjan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A R S Y E T I M**

Grupi i operatorëve ekonomik “Parajsa & Emsa”- Lipjan , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 06.11.2020 me nr. 900/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica”, me nr. të prokurimit: 613-20-2177-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 64, 68, 69, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe 9.1 & 9.2 i FDT-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmérinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 17.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se pas vendimit te PSH-se, AK-ja aktivitetin e prokurimit ne fjale e kthen ne rivlerësim dhe pas rivlerësimit te ofertave autoriteti kontraktues e shpall te papërgjegjshëm OE ankues, lidhur me autorizimet e ofruara duke e arsyetuar se OE ankues ka ofertuar me variante.

Eksperti shqyrtues sa i përket arsyses se eliminimit qe ka te beje me autorizimin e ofruar nga OE ankues, sqaron se kjo çështje është trajtuar me pare edhe me vendimet me nr. 454/20 dhe 669/20. Prandaj, konform rregullores se punës eksperti shqyrtues e vlerëson si çështje te gjykuar me pare “Res Judicata”.

OE ankues, ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, për te

cilin pretendon se i rekomanduari per kontrate nuk ka ofruar dëshmi për Kamion transportues me peshe bartëse mbi 10 m<sup>3</sup> min (2 cope) sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë pretendim sqaron se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar librezat e kamionit me nr. 01-448-MC me peshë 10518cm<sup>3</sup> dhe kamion 01-419-AI me peshë 11967cm<sup>3</sup>, prandaj, eksperti shqyrtues, e vlerëson si te paqëndrueshëm pretendimin e OE ankues për faktin se sipas dëshmive – librezës kapaciteti i kamionëve është siç është svaruar edhe me larte.

OE ankues, po ashtu pretendon se pajisja Liebherr L506 sipas dëshmive te prezantuara nga OE i rekomanduar për kontrate, nuk kanë validitet, me arsyetimin se AK-ja, ka kërkuar qe për automjetet qe regjistrohen Libreza e qarkullimit me validitet.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar librezën, sigurimin e automjetit e lëshuar nga kompania Scardian, pastaj certifikaten e kontrollit teknik te pajisjes dhe një deklarate me shkrim ne te cilën thuhet se për shkak te situatës se pandemisë QRA-ja, nuk janë duke lëshuar tabela.

Duke u bazuar ne deshmit e ofruara eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm përfaktin se nuk ka validitet ne librezën e OE i rekomanduar për kontrate për pajisjen ne fjale, mirëpo nga deshmit e ofruara i rekomanduari për kontrate ka dëshmuar se është ne proces te vazhdimit te validitetit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se i rekomanduari për kontrate pajisjen Traktor 4x4 për bartjen e materialeve përgjatë shtratit te lumit, nuk e ka dorëzuar sipas kërkesës, me arsyetimin se e ka dorëzuar një Traktor 4x4 lopat dhe se ky traktor sipas OE ankues hyn ne kategorinë e ngarkuesve.

Eksperti shqyrtues, sqaron se sipas dëshmive te ofruara nga OE i rekomanduar për kontrate, deshmit janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit prandaj edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në svarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te mbetet ne fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 17.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 19.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe lusim panelin qe te mbaj seancë për vendimin përfundimtar.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të operatorëve ekonomik “Parajsa & Emsa”- Lipjan, se AK e ka eliminuar OE ankues lidhur me autorizimet e ofruara duke e arsyetuar se OE ankues ka ofertuar me variante.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron, sa i përket arsyes së eliminimit që ka të bëjë me autorizimin e ofruar nga OE ankues, kjo çështje është trajtuar më parë edhe me vendimet me nr. 454/20 dhe 669/20. Prandaj, konform rregullores së punës, ky pretendim është çështje e gjykuar me parë “Res Judicata”.

Kurse, sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “Parajsa & Emsa”- Lipjan lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, për të cilin pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar dëshmi për kamion transportues me peshë bartëse mbi 10 m<sup>3</sup> min (2 cope) sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar librezat e kamionit me nr. 01-448-MC me peshë 10518cm<sup>3</sup> dhe kamion 01-419-AI me peshë 11967cm<sup>3</sup>. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, e vlerëson si të paqëndrueshëm pretendimin e OE ankues për faktin se sipas dëshmive – librezës kapaciteti i kamionëve është siç është sqaruar edhe më lartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Parajsa & Emsa”- Lipjan, se pajisja Liebherr L506 sipas dëshmive të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk kanë validitet me arsyetimin se AK-ja ka kërkuar që për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar librezën, sigurimin e automjetit e lëshuar nga kompania Scardian, pastaj certifikaten e kontrollit teknik të pajisjes dhe një deklaratë me shkrim në të cilën thuhet se për shkak të situatës së pandemisë, QRA-ja nuk janë duke lëshuar tabela.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm për faktin se nuk ka validitet në librezën e OE të rekomanduar për kontratë

për pajisjen në fjalë. Mirëpo, nga dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, i njëjtë ka dëshmuar se është në proces të vazhdimit të validitetit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Parajsa & Emsa”- Lipjan, se i rekomanduari për kontratë pajisjen Traktor 4x4 për bartjen e materialeve përgjatë shtratit te lumit, nuk e ka dorëzuar sipas kërkesës, me arsyetimin se e ka dorëzuar një Traktor 4x4 lopat dhe se ky traktor sipas OE ankues hyn në kategorinë e ngarkuesve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas dëshmive të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, dëshmitë janë sipas kërkesës së dosjes se tenderit prandaj edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke bërë vlerësimin sipas kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë, gjithashtu është respektuar edhe neni 60 ku kriter per dhënie te kontratës ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK Lipjan”;
- 1x1 OE “PARAJSA&EMSA”-Lipjan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.